Mbështesim zhvillimin e kompetencave transkulturore për profesionistët e shëndetit në Ballkanin perëndimor.

Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans, TCCWB

SHKOLLË DIMËRORE

9-13 Shkurt 2026
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër
Albania



Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

Tema 1: NJOHURI TË PËRGJITHSHME MBI KOMPENCAT NDËRKULTURORE


- Çfarë janë kompetencat kulturore?
- Përse nevojiten ato?
- Rëndësia e tyre në sistemin shëndetësor
- Cilat janë kompetencat kulturore?
- Si të bëjmë vlerësimin kulturor të pacientit?



Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

ÇFARË JANË KOMPETENCAT KULTURORE?



Kompetencat kulturore për infermierët janë
***aftësitë**
***njohuritë**
***qëndrimet**
që infermierët duhet të kenë për të ofruar kujdes shëndetësor të përshtatshëm dhe efektiv për pacientë nga kultura të ndryshme.

Këto kompetenca janë thelbësore për të siguruar shërbim të barabartë dhe për të shmangur diskriminimin kulturor.

Infermieria transkulturore




Infermieria transkulturore është një aspekt thelbësor i kujdesit shëndetësor aktual.
Popullsia në rritje dhe multikulturore paraqet një sfidë të rëndësishme për infermierët.
Nevojitet që infermierët të njohin dhe vlerësojnë ndryshimet kulturore në vlerat, besimet dhe zakonet e pacientëve të tyre.

Kujdesi infermieror i plotësuar me kompetencat kulturore ndihmon në sigurimin e kënaqësisë së pacientit dhe rezultateve pozitive të punës.
Nevoja për infermieri ndërkulturore do të vazhdojë të jetë një aspekt i rëndësishëm në kujdesin shëndetësor.

Konceptet ndërkulturore na ndihmojnë të transformojmë mënyrën të menduarit në mënyrë që të jemi infermierë të aftë për kujdes të sigurt, të menduar dhe etik për individë, familje, grupe dhe komunitete me prejardhje të ndryshme.

Kompetencat infermierore transkulturore - kërkesë e kohës!

- Popullsia në rritje
- Diversiteti kulturor
- Rritja e kërkesës për cilësi shërbimi
- Globalizimi/ integrimi





migrantët

minoritetet/ pakicat kombëtare

persona me aftësi të kufizuara fizike

turista

refugjatët

punëtorët sezonalë

persona me sëmundje mendore



të cënueshëm

barazi

në disavantazh

përfshirje

të ndryshëm nga ne

mirkuptim

të nën/papërfaqësuar

Dhembshuria

Empatia

Drejtësia

Rrisin kënaqësinë e pacientit



Barazia sociale

Qëndrueshmëria e risive

Përmirësimi

Përmirësojnë shërbimin shëndetësor



Advokim për të drejtat e njeriut


Etika

Profesionalizmi

UNIVERSITETI I SHKODRËS · UNIVERSITETI - EQREM ÇABEJ - GJIROKASTËR · UNIVERSITY OF ZENICA · UNIVERZITET U ISTOČNOM SARAJEVU University of East Sarajevo · FOR IMPROVING HEALTH CARE AND SOCIAL WELFARE FONDACIJAfami ZA UNAPREĐENJE ZDRAVSTVENE I SOCIJALNE ZAŠTITE · Odisee UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES · TURKU AMK TURKU UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES

Inteligjenca emocionale

- Sipas Goleman (1995) inteligjenca emocionale formon thelbin e ndërveprimeve tona, duke na mundësuar të lundrojmë në rrjetin kompleks të emocioneve që lindin në kontekste të ndryshme kulturore.
- Goleman identifikon pesë elementë kritikë që mbështesin inteligjencën emocionale, secili duke luajtur një rol kyç në **përmirësimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe lehtësimin e komunikimit efektiv përtej ndarjeve kulturore**:



Inteligjenca emocionale në profesionin e infermierit



1. **Vetëdija**

Infermierët duhet të jenë shumë të vetëdijshëm për paragjykimet e tyre kulturore.
Vetëdija bën të mundur që këto paragjykime të mos ndikojnë në ndërveprimet tona me pacientët me kultura të ndryshme.

Fakt: Identiteti kulturor ndikon në perceptimet dhe sjelljet e të dyja palëve (pacient –infermier) në mjediset klinike.

Inteligjenca emocionale në profesionin e infermierit




Fakt: Vetërregullimi kultivohet dhe përmirësohet me kalimin e viteve.

2. **Vetërregullimi**

Infermierët që punojnë në një kontekst ndërkulturor duhet të rregullojnë emocionet e tyre në mënyrë efektive për të trajtuar situata potencialisht të ndjeshme ose sfiduese që mund të lindin nga keqkuptimet kulturore.
Vetërregullimi i ndihmon infermierët të ruajnë etkën dhe profesionalizmin edhe kur ndryshimet kulturore mund të shkaktojnë reagime të forta emocionale.

Inteligjenca emocionale në profesionin e infermierit




Fakt: Ky është element kyç për sukses në çdo fushë.

3. **Motivimi i brendshëm**

Motivimi i brendshëm i shtyn infermierët të mësojnë vazhdimisht rreth kulturave dhe praktikave të ndryshme shëndetësore.

Ky motivim i brendshëm na frymëzon të shkojmë përtej kërkesave themelore të kujdesit shëndetësor dhe të kërkojmë mënyra për të përmirësuar ofrimin e kujdesit me ndjeshmëri kulturore, duke përmirësuar kështu rezultatet e punës sonë.

Inteligjenca emocionale në profesionin e infermierit



Fakt: Empatia është element kyç në shërbimin shëndetësor.

4. Empatia


Empatia është veçanërisht e rëndësishme në shëndetësi.

Ajo përfshin të kuptuarit e emocioneve dhe përvojës së një pacienti.

Infermierët duhet të jenë në gjendje ta vendosin veten në vendin e pacientëve të tyre, duke kuptuar ndjenjat dhe perspektivat e tyre, të cilat formohen nga vlera kulturore ose fetare të ndryshme nga të infermierit.

Kjo qasje empatike është çelësi për ndërtimin e besimit dhe raportit.

Inteligjenca emocionale në profesionin e infermierit



Fakt: Aftësitë sociale përcaktojnë cilësinë e marrdhënieve njerëzore.

5. Aftësitë sociale

(lidership, zgjidhje konfliktesh, ruajnë marrdhëniet me njerëzit)
Aftësitë sociale janë thelbësore për të komunikuar në mënyrë efektive me pacientët dhe familjet e tyre, të cilët mund të vijnë nga kultura të ndryshme nga e jona, në mënyrë që të ofrojmë kujdes shëndetësor duke respektuar botëkuptimin e pacientit.

-për të shpjeguar procedurat mjekësore në një mënyrë që është respektuese dhe e ndjeshme ndaj dallimeve kulturore,
-ndërmjetësimin për tu kuptuar



CILAT JANË KOMPETENCAT KULTURORE PËR INFERMIERËT?

1. Ndërgjegjësimi kulturor (Cultural Awareness)
Të njohin dhe të kuptojnë vlerat, besimet dhe zakonet kulturore të vetes dhe të të tjerëve.
Të jenë të vetëdijshëm për paragjykimet e tyre personale dhe si ato mund të ndikojnë në kujdesin shëndetësor.



2. Njohuritë kulturore (Cultural Knowledge)
Të kenë njohuri për kultura të ndryshme, përfshirë mënyrën se si ato ndikojnë në perceptimin e shëndetit, sëmundjes, dhe trajtimit.
Të kuptojnë ndikimin e gjuhës, fesë, dietës, dhe zakoneve të tjera në kujdesin ndaj pacientëve.



3. Aftësitë ndërkulturore (Cultural Skills)
Të mbledhin informacion të saktë për historinë shëndetësore dhe nevojat e pacientëve me ndjeshmëri kulturore.
Të përdorin metoda të komunikimit që respektojnë dhe përfshijnë diversitetin kulturor (p.sh., përdorimi i përkthyesve).

ÇFARË JANË KOMPETENCAT KULTURORE?



4. Ndjeshmëria kulturore (Cultural Sensitivity)
Të demonstrojnë respekt për dallimet kulturore dhe të shmangin stereotipizimin.
Të ofrojnë kujdes që respekton zgjedhjet personale të pacientëve bazuar në kulturën e tyre.



5. Komunikimi ndërkulturor (Cross-cultural Communication)
Të përdorin gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, duke shmangur zhargonin mjekësor.
Të tregojnë empati dhe durim kur përballen me barriera gjuhësore ose mosmarrëveshje kulturore.



Pse janë të rëndësishme këto kompetenca?

- Përmirësojnë **cilësinë e kujdesit shëndetësor**.
- Ndihmojnë në ndërtimin e **besimit mes pacientit dhe stafit**.
- Ulin rrezikun e **keqkuptimeve** dhe **gabimeve klinike**.
- Nxisin **barazi në kujdesin shëndetësor**.



Si konkluzion, **kompetencat kulturore janë pjesë e domosdoshme e praktikës infermierore moderne dhe ndihmojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore për të gjithë pacientët, pavarësisht prejardhjes së tyre.**

Si të bëjmë vlerësimin kulturor të pacientit?



Seksioni	Elementët
Gjuha dhe komunikimi	Gjuha e preferuar: _____ Nevojë për interpretues: PO / JO Kontakti: _____
Identiteti kulturor & shpirtëror	Identiteti/etnia: _____ Feja/spiritualiteti: _____
Preferenca për vendimmarrje	Kush vendos: _____ Dëshiron familjarë gjatë procedurave: PO / JO Emra dhe kontaktet e tyre: _____
Besime/praktika shëndetësore	Mendim për shkakun e sëmundjes: _____ Trajtime tradicionale: PO / JO — cilat: _____ Kundërshtime ndaj trajtimeve: _____
Ushqimi/dieta	Kufizime dietike: _____ Orët/preferencat e vakteve: _____
Privatësia	Preferencë për gjininë e stafit: _____ Kufizime për ekzaminimin me palpacion: _____
Shprehja e dhimbjes/emocioneve	Si e shpreh dhimbjen/ankthin: _____ Nevojë për mbështetje psikologjike: PO / JO
Ceremoni/rituale për vdekjen	Nevoja për rituale/ceremoni: PO / JO _____

Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans, TCCWB





Referoi: Zhenisa Çuni MD, PhD

University of Gjirokastër, Albania
zhcuni@uogj.edu.al



Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union













УНИВЕРЗИТЕТ У ИСТОЧНОМ САРАЈЕВУ
University of East Sarajevo



FONDACIJA fami
FOR IMPROVING HEALTH CARE AND SOCIAL WELFARE
ZA UNAPREDJENJE ZDRAVSTVENE I SOCIJALNE ZAŠTITE



Odisee
UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES

TURKU AMK
TURKU UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES